



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:072378

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766146

KPPP.nr. 1310/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" SH.A., me seli në Prishtinë, rr. "Hazir Shala", Nr. 4, kundër debitorit RTV 21, me seli në Prishtinë, rr. "Dritan Hoxha", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Idriz Daci, avokat nga Gjakova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 437/21 të datës 25.03.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit RTV 21, me seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET Urdhri Përbarimor P.nr. 437/21 të datës 25.03.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" SH.A. me datë 25.03.2021 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 437/21 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Kartela Financiare e Konsumatorit për periudhën 01.01.2013 deri më 22.03.2021, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t'ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 1,721,65€ (një mijë e shtatëqind e njëzet e një euro e gjashtëdhjetë e pesë cent), bashkë me kamatë vjetore deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me duke kundërshtuar në tërësi borxhin e paraqitur përmes Financiare e Konsumatorit për periudhën

01.01.2013 deri më 22.03.2021, pasi sipas debitorit e njëjta nuk është dokument i besueshëm. Po ashtu thekson se borxhi është parashkruar, andaj kreditori nuk mund të realizoj pagesat për shkak që ka kaluar afit ligjorë për kërkimin e borxhit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj të tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizoj Urdhrin Përmbarimor P.nr. 437/21 të datës 25.03.2021 pasi që i njëjti është lejuar mbi bazën e një dokument i cili nuk i plotësoj kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, me theks të veçantë pretendimet për parashkrimin e borxhit me pretendimin se përmes pranimit të borxhit debitori ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimorë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Kartela Financiare e Konsumatorit për periudhën 01.01.2013 deri më 22.03.2021 mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 e LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga ekstrakti afarist, rezulton se borxhi prej 1,721.65€ është krijuar për periudhën kohore 2013 e deri në 2021, pra në fund të këtij ekstrakti është paraqitur shuma totale e mbledhur për periudhën e lartcekur.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1310/22, datë 31.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.